



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.125/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga Muhamet Rexha, kryesues, Xhevdet Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), paraqitur kundër Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ), në lidhje me mostransparencë gjate procesit të shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve të parakohshme 2010-2011 për Asamblene Parlamentare të Kosovës, në seancën e mbajtur më 02.02.2011, mori:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN).

ARSYETIMI

Me datë 31.01.2011 PZAP-i ka pranuar ankesë nga BIRN-i në të cilën theksohet se “me 30.01.2011 KQZ-ja ka shpallur rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të 12 Dhjetorit. Publikimin e këtyre rezultateve KQZ-ja e ka bërë pa shpallur fare rezultatet e zgjedhjeve nga vendvotimet. Kjo mungesë e transparencës për të cilën LQP nuk jep zgjedhje konkret, është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 19 dhe 40) dhe Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (neni 19). Në bazë të kësaj qytetarët e Kosovës dhe vëzhguesit e subjekteve të ndryshme nuk e dinë nëse këto janë në përputhshmëri me rezultatet e vendvotimeve”. Parashtruesi i ankesës kërkon që PZAP ta obligoj KQZ- në që të bëjë publikimin e rezultatit të zgjedhjeve të të gjithë vendvotimeve, si dhe kërkojnë që te obligohet KQZ që te publikoj metodologjinë që është përdorur për alokimin e ulëseve në parlament në mënyrë që nuk është e qartë për publikun se si është bërë kalkulimi. Parashtruesi i ankesës pretendon se pa publikimin e këtyre dy informavate publikimi është i pakompletuar dhe jotransparent.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstaton se ankesa është e pabazuar për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe pretendimet e ankuesit se KQZ nuk i ka publikuar rezultatet e zgjedhjeve për secilin vendvotim veç e veç nuk qëndrojnë pasi që të gjitha të dhënat e rezultateve, edhe ato për të cilat pretendon ankuesi gjinden në Web faqen e KQZ-së, ndërsa rreth metodologjisë së ndarjes së vendeve në parlament e gjithë kjo është paraparë me nenin 111 të LZP-së. Për këto arsye dhe bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 125/2011 më datën 02.02.2011.

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha

